



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 23.09.2019

Në mbështetje të Nenit 53 (paragrafit 3) dhe nenit 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221 dhe Ligjin Nr. 04/L-116, bazuar në nenin 8 dhe 16 të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Thirrjes Publike të MZHR-së së datës 09.08.2019 për mbështetje financiare të projekteve/ programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar, si dhe vendimin Nr. 823, dt. 29.08.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MZHR-së për Themelimin e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve të pranuar nga OJQ-të për mbështetje financiare publike në fushën e avancimit të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, Komisioni vlerësues nxjerrë këtë:

V E N D I M

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara në vendimin e lartpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 09 Gusht 2019, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dorëzuar/dërguar nga OJQ-të në MZHR, ku sipas kriterëve Komisioni vlerësues ka shpallur fituesit që kanë aplikuar për objektiven **2.1. Promovimi i Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar**: OJQ "Marimangat e Pejës", OJQ "LYC", OJQ "Valet e Paqes", OJQ "Intituti për studime të avancuara 2M", OJQ "North Youth Movement", OJQ "Sofra", **2.2. Nxitja e rrjetëzimeve me qëllim të zhvillimit socio - ekonomik rajonal**: OJQ "Center For Education and Training", OJQ "Organizata studentore e Fushë Kosovë", OJQ "Green-A", kurse për objektivin **2.3. Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik**: OJQ "Royal", OJQ "Youth Education Center".

A R S Y E T I M

Komisioni brenda afatit të përcaktuar me Planin e veprimit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni. Në fazën e parë në bazë të kriterëve formale nga pesëdhjetë e katër (54) aplikacione, kriteret formale i kanë plotësuar tridhjetë e katër (34) prej tyre.

Fazës së dytë të vlerësimit i janë nënshtruar tridhjetë e katër (34) projekte të OJQ-ve, sipas kriterëve të Thirrjes Publike, Komisioni ka vlerësuar se njëzet e tre (23) nga këto OJQ nuk i plotësojnë kriteret e fazës së dytë (vlerësimit përmbajtësor) për të fituar financimin nga MZHR: AZHR "Lindje", AZHR "Jug", AZHR "Perëndim", OJQ "Iniciativa e femrës kosovare" OJQ "AIPK" OJQ "Llogaritari" OJQ "Qendra për Avancimin e Shoqërisë" AZHR "Qendër" AZHR "Veri" OJQ "Mundësia" OJQ "Shoqata e grave afariste" OJQ "START-UP" OJQ "SHMGGRM" OJQ "Bota e Rinisë" OJQ "Dita" OJQ "Vizionida" OJQ "Shtëpia ime e drejta ime" OJQ "Rinia" OJQ "Bisness Women Mitrovica" OJQ "CECD-Friends OJQ "CD&E" OJQ "IZHQ" OJQ "Akademia".

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara me planin e punës të miratuar nga të gjithë anëtarët e komisionit, Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës, duke vlerësuar secilin projekt - propozim veç e veç sipas Thirrjes Publike të datës 09 Gusht 2019.

Komisioni ka patur parasysh Rregulloren mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, rregullat e punës si aneks i kësaj rregulloreje dhe Thirrjen Publike nga MZHR të datës 09 Gusht 2019.

Afati i OJQ-ve për aplikim për dorëzimin e projekt-propozimeve ishte nga data 09 Gusht deri më 30 Gusht 2019.

Sipas Thirrjes Publike, kriteret e përcaktuara ishin të ndara në ato të përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

Për të qenë e pranueshme për këtë thirrje organizata aplikuese duhet të:

- Jetë e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare.
- Jetë e pajisur me numër fiskal – të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovë.
- Ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit.
- Ketë përvojë dhe veprimtari në fushën e qeverisjes lokale.
- Ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme.
- Mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrues apo likuidimit.
- Mos ketë shkelur kushtet e parashikuara të përdorimit të fondeve publike.
- Mos të ketë pranuar mjete financiare për të njëjtin aktivitet gjatë këtij viti. Prandaj me rastin e aplikimit kërkohet deklarata për shmangien e financimit të dyfishtë;
- Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit së bashku me formularin e propozim buxhetit.

Gjatë vlerësimit dhe përcaktimit të këtyre kriterëve, Komisioni vlerësues u pajtua që njëzetë e tre (23) projekt-propozime të diskualifikohen.

Kriteret e veçanta:

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësoj edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- Të dorëzoj brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike.
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike.
- Të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes.
- Të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme.
- Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve/ programeve të ngjashme duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes përkatëse.
- Të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.

Nga kjo, Komisioni ka konstatuar se nga gjithsejtë tredhjetë e katër (34) projekt-propozime të OJQ-ve që i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe rrjedhimisht kanë kaluar në fazën e dytë të vlerësimit, njëmbëdhjetë (11) prej tyre i plotësojnë edhe kriteret e veçanta për t'u kualifikuar si përfituese të financimit nga MZHR.

Pjesë e vendimit është edhe raporti i Komisionit për OJQ-të përfituese të listës preliminare, i cili është shpallur në ueb faqen zyrtare të MZHR-së me datë 09.09.2019.

Komisioni i vlerësimit të projekt-propozimeve të OJQ-ve:

Erlina Llabjani, Kryesuese

Ekzotina Brahimaj, Anëtare

Shkëndije Dinaj, Anëtare

Valmira Shatri, Anëtare

Sanela Klimenta, Anëtare





